



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE INTEGRIMIT PROKURIMEVE DHE ASETEVE
Sektori i Aseteve

PROJEKT VENDIM

Nr 12 Datë 20.10 2023

Rishikim i VKB-së nr 56, datë 23. 09. 2022, “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes përgjithshme prej 42.55 Ha, e llojit “Kullotë”, me afat deri 10 vjet, e shtrirë në pasuritë nr 425/3, 425/4, 425/6, 456, 441, Zk nr 3389, fshati Shkjezë, dhe pasurinë nr 148/1, Zk nr 2993, fshati Plezhë, pronë e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës të jetë: “Për ndërtim parku fotovoltaik, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj) .”

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, neni 27 pika 5, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.08.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, i ndryshuar, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, VKM nr 559, dt 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes së përgjithshme prej 42.55 Ha, e llojit “Kullotë”, duke saktësuar sipërfaqet, numrat e pasurive, si dhe plotësimin e dokumentacionit me çertifikata pronësie (ose me dokument hipotekor për vërtetim pronësie), për secilën pasuri. Numrat e pasurive me sipërfaqet përkatëse sipas plan rievimeve bashkëlidhur, që propozohen të jepen në përdorim janë përkatësisht: **Nr 425/3, 425/4**, (pjesë), **425/6**, (pjesë), **456**, dhe **441, Zk nr 3389**, në fshatin Shkjezë, dhe nr **148/1** (pjesë), që ndodhet në fshatin Plezhë, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës.
Fusha e përdorimit të pronës: Për ndërtim parku fotovoltaik, aerogjeneratorë, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj).

2. Efektet: Jep impakt pozitiv, në komunitet, duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera dysheme e qirasë vjetore të jetë në përputhje me VKM-në nr 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", sipas tabelës nr 8/4.
4. Pas miratimit në Këshill Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut, do të vazhdohet procedura me të gjithë elementet e saj përbërës, për dhënie në përdorim të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr 1, datë 09.06.2016, të Ministrisë së Mjedisit "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

HARTOI PROJEKT VENDIMIN

P/sek Aseteve: Ndoc Baqli

Miratoi: Drejtori Bib Miria




KRYETARI
Kristian SHKRELI



Konfirmoi bazën ligjore:

Spektori Ligjor

Juriste





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETJEVE

SEKTORI ASETJEVE

RELACION

Rishikim i vendimit nr 56, datë 23.09.2022, “Dhënie në përdorim të pasurisë shtetërore të llojit “Kullotë”. Fusha e përdorimit: “Për ndërtim parku fotovoltai”, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. “Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi”.

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia në përdorim të tretëve e pronave të Bashkisë.

Udhëzimi nr 1 i Ministrisë së Mjedisit, datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit kullosor publik” pika 7.

Referuar shkresës së Prefektit të Qarkut Shkodër me nr 627/1 prot, datë 07.10.2022, mbi VKB nr 56, datë 23.09.2022, kemi bërë rishikimin e VKB-së sipërcituar, duke saktësuar numrat e pasurive bashkë me sipërfaqet përkatëse sipas plan rievimit bashkëlidhur oër çdo pasuri, si dhe duke bërë plotësimin e dokumentacionit me çertifikata pronësie ose me vërtetime nga dokumenti hipotekor.

Sipërfaqja prej 42.55 ha që propozohet të jepet me qira, shtrihet **në 6 pasuri, dhe në 2 Zona kadastrale**. Disa pasuri pasqyrohen në projekt vendim me sipërfaqe siç janë në çertifikatë, dhe disa të tjera me pjesë sipërfaqesh, të saktësuar sipas plan rievimeve bashkëlidhur, përkatësisht; Sipërfaqja prej **10.5 ha** në pasurinë nr **425/3**. Sipërfaqja prej **3.7366 ha** pjesë e pasurisë nr **425/4**. Sipërfaqja prej **1.3934 ha** pasuria nr **425/6**. Sipërfaqja prej **5.8759 ha** pasuria nr **456**. Sipërfaqja prej **0.5441 ha** pasuria nr **441**, të ndodhura në **ZK nr 3389**, fshati Shkjezë,dhe Sipërfaqja prej **10.5 ha**, pjesë e pasurisë nr **148/1, Zk 2993**, në fshatin Plezhë.

Pasuritë e mësipërme, objekt i këtij projekt vendimi janë pronë e Bashkisë Vau Dejës, të paisura me çertifikatë pronësie, ose me vërtetim nga dokumenti Hipotekor.

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak dhe shprehjes së Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me shpalljen në Buletinin e njoftimeve publike, duke ndjekur procedurat me të gjithë elementët e saj përbërës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, deri në lidhjen e kontratës me subjektin fitues.

Bazuar në VKM-në nr. **559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika 8/4, në funksion të sipërfaqes që propozohet dhe që bazohet në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës si dhe kategorinë e përdorimit **rezultojnë si më poshtë.**

8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet
4.	Kullotë	192.000	184.000	176.000

Pas nr 425/3 me Sip prej **10.5 ha** x 176 000 lek = **1 848 000** lek/vit.

Pas nr 425/4 me Sip prej **3.7366 ha** x 176 000 lek = **657 641, 6** lek/vit

Pas nr 425/6 me Sip prej **11.3934 ha** x 176 000 lek = **2 005 238, 4** lek/vit

Pas nr 456 me Sip prej **5. 8759 ha** x 176 000 lek = **1 034 158, 4** lek/vit

Pas nr 441 me Sip prej **0.5441 ha** x 176 000 = **95 761, 6** lek/vit

Pas nr 148/1 me Sip prej **10.5 ha** x 176 000lek = **1 848 000** lek/vit


Në total, sipërfaqja prej 42.55 ha x 176 000 lek = 7 488 800 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë/vit.

Për sa më sipër, ju ftojmë për miratimin në parim të dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **42.55 ha** “Për ndërtim parku fotovoltaike”, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj).


Duke ju falenderuar, ju urojmë punë të mbarë.

Grupi i Punës

Ing.Mark Suli



Ndoc Baqli



Ilda Prendi



RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NE PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS, “PËR PARK FOTOVOLTAIK”, (AEROGJENERATORE, STACIONET, OBJEKTET PËRKATËSE ETJ.)”

Bazuar në **urdhërin nr. 20, datë 26.1.2023**, të Kryetarit të Bashkisë “Për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore për dhënie në përdorim të fondit kullosor”, grupi i punës i përbërë nga Z. Ndoc Baqli, Përgjegjës i Sektorit të Aseteve, Z. Mark Suli, Specialist i Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, dhe Zj. Ilda Prendi, Specialiste, nga data **2.10.2023** deri në datën **5.10.2023**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes kullosore **prej 42.55 ha**, “Për park fotovoltaik” (aerogjeneratorë, stacionet, objektet përkatëse etj).

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM-së nr. 246, datë 31.3.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 68, datë 28.1.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, rezulton se sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **42.55 ha**, “Për ndërtim parku fotovoltaik”, (aerogjeneratorë, stacionet, objektet përkatëse etj), shtrirë në **pasuritë nr. 425/3, nr. 425/4, nr. 425/6, nr. 456, nr. 441, Zk nr. 3389, fshati Shkjezë dhe pasurinë nr. 148/1, Zk nr. 2993, fshati Plezhë**, që janë në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie dhe vërtetim nga dokumenti hipotekor.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat nr. 1 dhe nr. 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: (sipas tabelave përkatëse bashkëlidhur)

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacion jepen në përdorim për një afat **deri 10 vjet**, për një sipërfaqe prej **42.55 ha**, “Për park fotovoltaik”, (aerogjeneratorë, stacionet, objektet përkatëse etj).”

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në VKM-në nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor/kullosor”, në VKM-në nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” të ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pika 2, gërma a dhe pika 7.

Sipërfaqja e marrë në studim do t'i nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik sipas legjislacionit në fuqi për dhënie në përdorim të pronës publike.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera proceduriale, sa më sipër, Kryetari i Bashkisë nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumenteve të konkurrimit publik nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullësor bazohen në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuara nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lek/vit konsiston në:

1. Vlerën e përdorimit lekë/ha në vit, sipas sipërfaqes së përgjithshme (shtrirë në pasuritë me nr e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse si më poshtë, për “Për park fotovoltaik”,(stacionet,objektet përkatëse etj)”

- a) Pasuria nr.425/3 me sipërfaqe prej 10.5 ha x 176 000 lek = **1.848 000** lekë/ vit
- b) Pasuria nr.425/4 me sipërfaqe prej 3.7366 ha x 176 000 lek = **657 641,6** lekë/ vit
- c) Pasuria nr.425/6 me sipërfaqe prej 11.3934 ha x 176 000 lek = **2 005 238,4** lekë/vit.
- d) Pasuria nr 456 me sipërfaqe prej 5.8759 ha x 176 000 lek = **1 034 158,4** lek/vit
- e) Pasuria nr 441 me sipërfaqe prej 0.5441 ha x 176 000 = **95 761,6** lek/vit
- f) Pasuria nr 148/1 me sipërfaqe prej 10.5 ha x 176 000 lek = **1 848 000** lek/vit.

Në total Sip prej 42.55 ha, me vlerën e çmimit prej 7 488 800 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind), lekë/vit.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Mark Suli



P/sek. Ndoc Baqli



Sp/ Ilda Prendi



KRYETARI

Kristian SHKRELI



PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

HAMID ÇULIQ

Licensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes. 15.09.2023

SIPERFAQE NË TOPOGRAFI

HAMID ÇULIQ

Sip = 5444 m² LICENSA - 0675/2

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ECNA KADASTRALE 3389

NR PASURISE 441

VOLI _____ DATE _____


SH. K. TA. 1/10/22

INDEKSI CHARITES : K-34-74-03-03

KLASA E PASURISE

TRASHI: SHKODER FSHATI: HIKOZE

ADRESA: BASHKIA VAL DEJES



PLAN RILE 7IMI

PERGATITI:

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes. 15.09.2023

SIPERFAQE

Sip = 58759 m²

1000000000
HAMID ÇULIQ
LICENSE-10070/6

IDENTIFIKIMI PASURISE

DOMA KADASTRALE 3389

NUMER PASURISE 456

VOL. _____ F. NR. _____


NUMER KADASTRAL

NUMER KADASTRAL : K-24 71-005

NUMER PASURISE

NUMER PERSHPODERESHAT/SHKURTIZE

SHITES: EASHKIA VAL DEJES



341

PLAN RREJIMI

PERGATITI:

HAMID ÇULIQ

Licënsa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes. 15.09.2022

**ING. TOPOGRAFI
HAMID ÇULIQ
LICËNSA T. 0675/2**

SIPERFAQE

Sip = 113934 m²

IDENTIFIKIMI PASURISE

NUMER KATASTRAL 3389

NUMER PASURISE 425/6

VOJBUETI _____


SHALLI _____

INDIKS: KHARTES : K - 34 - 76 - 34 - B

NUMER PASURISE _____

NUMER KODER PSHAT: SHALLI _____

NUMER BASHKIA VAL DEJES _____



6 - (34 - B)

PLAN RILEVIMI

PERGATITI:

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes. 15.09.2023

SIPERfaqe

Sip = 37366 m²

ING. TOPOGRAFI
HAMID ÇULIQ
LICENCE-0675/2

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3389

NR PASURISE 425/4-S1

VOL ___ FAQE ___


SHKALA 1:5000

INDEKSI I HARTES : K - 34- 76 -(34 -B)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: SHKJEZE

FOROSITES: BASHKIA VAU DEJES





SHKALLA 1:2500

SHPJEGUES
Siperfaqe: S=105 000 m²



Nr. PASURISE	TIPI I KUFITARIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren, O-Ortofoto
 Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total;
 D-Matje Distancash.
PERCAKTIMI I KUFIRIT: HK- Harte Kadastrale
 Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht;
 PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.
SHENIME TE VECANTA: